



THIRRJE PËR APLIKIM

Trajnim i Specializuar për Hetimet Financiare dhe Rikuperimin e Aseteve

Akademia e Drejtësisë e Kosovës dhe Instituti i Bazelit për Qeverisje – Qendra Ndërkombëtare për Rikuperim të Aseteve, si partner implementues i Zyrës së UNDP në Kosovë, kanë kënaqësinë të ofrojnë mundësi trajnimi për gjyqtarët penalistë dhe prokurorët në trajnim me temën: Hetimet Financiare dhe Rikuperimi i Aseteve, që do të mbahet nga data **7 deri me 11 nëntor 2022**.

Qëllimi kryesor i këtij programi trajnimi është intensifikimi dhe ngritja e kapaciteteve hetimore në Kosovë për të hetuar dhe ndjekur me sukses rastet e korrupsionit dhe pastrimit të parave, si dhe rikuperimin e pasurisë. Duke u fokusuar në marrjen e njohurive të plota të elementeve të korrupsionit dhe veprave penale të pastrimit të parave në legjislacionin e Kosovës, dhe duke përmirësuar të kuptuarit e proceseve dhe procedurave ligjore dhe praktike për rikuperimin e asetëve jashtë vendit, hetuesit dhe prokurorët do të zhvillojnë aftësitë e nevojshme.

QËLLIMI

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi të specializuar është përmirësimi i kapacitetin e hetuesve dhe prokurorëve kundër korrupsionit, gjyqësorit, dhe në mënyrë ideale edhe të tjera kyçe të zbatimit të ligjit në Kosovë dhe agjencive përkatëse, në analizimin, hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve ndërkombëtare të pastrimit të parave dhe/ose ryshfetit. Më e rëndësishmja, ky trajnim do të ndihmojë autoritetet në rritjen e aftësisë së stafit të tyre për të trajtuar kërkesat ndërkombëtare dhe për të pasur sukses në bashkëpunimin me juridiksionet e huaja në luftën kundër pastrimit të parave dhe riatdhesimit të pasurive të vjedhura.

Trajnimi mbulon fazat fillestare të hetimit dhe të hetimit gjyqësor, gjatë të cilave mblidhen dhe verifikohen informacionet dhe provat dhe identifikohen dhe lokalizohen asetet, duke përdorur një sërë teknikash hetimore. Ai gjithashtu ofron udhëzime që synojnë të sigurohet që elementët e veprave të përzgjedhura mund të mbështeten siç duhet nga provat e mbledhura. Trajnimi vë në pah rëndësinë e përputhjes së provave me elementët specifikë të veprës penale në fjalë, dhe përdorimin e teknikave përkatëse për burimin e provave të nevojshme për të dënua dhe, në fund, për të konfiskuar të ardhurat e korrupsionit dhe pastrimit të parave. Njohja e plotë e elementeve të veprës penale, për më tepër, lehtëson Ndihmën Juridike Ndërkombëtare (NJN) efektive me juridiksionet e huaja, veçanërisht në rastet e korrupsionit, pastrimit të parave dhe rasteve të tjera të krimit të rëndë ekonomik, ku i pandehuri shpesh fsheh jashtë vendit pasurinë e fituar nga krimi.

KOHËZGJATJA E TRAJNIMIT

Trajnimi do të zgjasë nga data 7 deri me 11 nëntor 2022.

OFRUESI I TRAJNIMIT

Instituti i Bazelit për Qeverisje – Qendra Ndërkombëtare për Rikuperim të Aseteve, i udhëhequr nga Phyllis Atkinson dhe Thierry Ravalomanda.

KUSH MUND TË APLIKOJË:

Gjykatësit dhe Prokurorët e Shtetit në departamentin special, departamentin e krimeve të rënda dhe departamentin e përgjithshëm. Numri maksimal i pjesëmarrësve është tetë (8) derisa vijimi i trajnimit do të mundësohet atyre që regjistrohen sipas radhës në platformë.

JU MUND TE SHPREHIN INTERESIMIN E JUAJ PËR TË MARRË PJESE NË TRAJNIM PËRMES REGJISTRIMIN NË PLATFORMË:

<https://ade.rks-gov.net/login/signup.php?lang=sq> - shqip

https://ade.rks-gov.net/login/signup.php?lang=sr_lt – serbisht

<https://ade.rks-gov.net/login/signup.php?lang=en> - anglisht

AFATI I FUNDIT PËR REGJISTRIM: 3 NENTOR 2022

Ky trajnim mundësohet nga Projekti i Zyrës së UNDP në Kosovë - SAEK III, i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar.